



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 06.03.2019, në orën 16:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Vjosa Osmani-Sadriu, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Srgjan Mitroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Morina, ZKM, Sanije Berisha, OSBE, Eugen Cakolli, Shpend Gashi, KDI, Perparim Kryeziu, GLSP dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Time Kadrijaj, zëvendëskryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë;**
3. **Shqyrtimi i Draft- Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë

Time Kadrijaj, Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, tha se është shqyrtuar në mbledhjen e komisionit të mbajtur, më 25 shkurt 2019, por kërkoi të përsëritet votimi për dy amendamentet e propozuara në projektligj nga deputeti Dukagjin Gorani.

Zëvendëskryetarja, pas procesit të votimit, konstatoi se komisionit nxori këtë

Përfundim

Amendamentet 1 dhe 2 të propozuara nga deputeti Dukagjin Gorani përkrahen njëzëri nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit.

Raporti me rekomandime lidhur me projektligjin i përcillet komisioneve kryesore për shqyrtim nga kompetenca e tyre.

3. Shqyrtimi i Draft- Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

Time Kadrijaj: Draft- platforma për dialogun tha se u është shpërndarë deputetëve, më 19 shkurt 2019, dhe se komisioni është ngarkuar në cilësi të Komisionit Funkcional që ta shqyrtojë dhe Kuvendit t'i paraqesë raport me rekomandime. Ajo theksoi se në mbledhjen e mbajtur, më 25 shkurt 2019, pas shqyrtimit të draft- platformës në komision nuk pati kuorum të mjaftueshëm për votimin e saj. Znj. Kadrijaj theksoi se debati lidhur me këtë pikë është shterur në mbledhjen e kaluar dhe propozoi që të hidhet në votim draft- platforma e propozuar.

Pas votimit të draft-platformës zëvendëskryetarja konstatoi se komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet, njëzëri nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit, Draft- platforma për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe procedohet në procedurë të mëtejme në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

**Zëvendëskryetarja e
komisionit**

Time Kadrijaj

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.**